REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Nr. 3052/4 Prot.

Date 18/08/2026.

Lenda : Relacion për Projekt Vendimin Nr.14," Tavanet e pëgjithshme përgatitore të PBA 2027-2029".

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", është përgatitur projekt-vendimi për miratimin e tavanet e pëgjithshme përgatitore të PBA 2027-2029.

Në kuadër të procesit të përgatitjes së **Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029, Faza II**, Bashkia Has ka realizuar procesin e planifikimit buxhetor në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi dhe gjithë procesi i PBA-së është realizuar në **Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV)**, ku janë hedhur dhe përpunuar të dhënat përkatëse të planifikimit buxhetor për periudhën 2027–2029.

Në këtë fazë janë përpunuar dhe konsoliduar kërkesat buxhetore të strukturave përkatëse, në përputhje me **tavanet e përcaktuara për periudhën afatmesme**, duke synuar një planifikim sa më realist të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2027, 2028 dhe 2029.

Duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojën për vijimin e procesit të hartimit të PBA-së, propozohet që **Këshilli Bashkiak Has të shqyrtojë dhe të miratojë tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 (Faza II).**

Bashkëngjitur Projektvendimit paraqiten **Tavanet e Përgjithshme Përgatitore të PBA 2027–2029**, të cilat përbëjnë pjesë të dokumentacionit të paraqitur për miratim.

Faleminderit për bashkepunimin.

KRYETAR

Miftar DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

Përgjegjëse Finance

Grislanda Bajraktari

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has.
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al.